



Njësia Nr./Br./No 01(Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 01/133 Nr. i faq./Br.str/No.pg 87

Data/Datum/Date 28/04/2026

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 17 shkronja a) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), nenit 5, nenit 6 paragrafi 1 pika 1.1 dhe nenit 8 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 5 paragrafi 1 pika 1.2, nenit 6, nenit 8 dhe nenit 17 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenit 10 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.4, nenit 40, nenit 57 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, të datës 29.3.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, në mbledhjen e mbajtur më datë 28.4.2026, merr këtë:

V E N D I M

Për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës

1. **Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës, nr. 02/7182/26, i datës 07.04.2026 dhe merret vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës personave fizikë dhe juridikë dhe zhvillimin e procedurave të ankandit publik për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër nga 1 (një) deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vjet.
2. Pronat e paluajtshme – lokalet afariste për dhënie në shfrytëzim sipas pikës 1 të këtij vendimi janë:
 - 2.1. O-71510057-106-0-2-0 në sipërfaqe të përgjithshme prej 58m² (pesëdhjetë e tetë metra katror), zona kadastrale qytet, në rr. "Gëzim Hamza", e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të komunës së Rahovecit;
 - 2.2. O-71510057-106-0-3-0 në sipërfaqe të përgjithshme prej 63m² (gjashtëdhjetë e tre metra katror), zona kadastrale qytet, në rr. "Gëzim Hamza", e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të komunës së Rahovecit;
 - 2.3. O-71510057-106-0-4-0 në sipërfaqe të përgjithshme prej 63m² (gjashtëdhjetë e tre metra katror), zona kadastrale qytet, në rr. "Gëzim Hamza", e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të komunës së Rahovecit;
 - 2.4. O-71510057-106-0-8-0 në sipërfaqe të përgjithshme prej 60m² (gjashtëdhjetë metra katror), zona kadastrale qytet, në rr. "Gëzim Hamza", e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të komunës së Rahovecit;
 - 2.5. O-71510057-106-0-9-0 në sipërfaqe të përgjithshme prej 60m² (gjashtëdhjetë metra katror), zona kadastrale qytet, në rr. "Gëzim Hamza", e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të komunës së Rahovecit;

- 2.6. O-71510057-106-0-10-0 në sipërfaqe të përgjithshme prej 60m² (gjashtëdhjetë metra katror), zona kadastrale qytet, në rr. "Gëzim Hamza", e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të komunës së Rahovecit.
3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim i pronës së paluajjtshme të komunës - lokaleve afariste të cekura në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi, është ruajtja dhe rritja e vlerës së pronës publike komunale dhe zhvillimi i aktivitetit biznesor, si dhe dhënia e mundësisë qytetarëve të vetëpunësohen, ku rritja e aseteve ekzistuese ndihmon në rritjen e vlerës së asaj prone.
 4. Afati kohor për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajjtshme të komunës, të cekura në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi, është afatshkurtër në periudhën prej 8 (tetë) vjet.
 5. Prona e paluajjtshme në fjalë nuk e ndërron titullarin juridik, pronar i saj mbetet Kuvendi Komunal i Rahovecit dhe si e tillë ajo nuk mund t'i jepet personit të tretë në shfrytëzim nga ana e shfrytëzuesit, nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo i çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë.
 6. **OBLIGOHET** Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Zyra e Prokurimit që, në bashkëpunim me komisionin për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajjtshme të komunës, të zhvillojë procedurat e konkurrimit të hapur, konform dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajjtshme të Komunës dhe Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajjtshme të Komunës.
 7. **AUTORIZOHET** Kryetari i Komunës që pas përfundimit të procedurave të ankandit publik, të përcaktojë me kontratë të veçantë të drejtat dhe përgjegjësitë e komunës dhe përfituesit të pronës së dhënë në shfrytëzim.
 8. Procedura për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajjtshme të komunës, realizohet përmes ankandit publik.
 9. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, nenit 8 dhe nenit 9 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2026 për procedurën e shqyrtimit administrativ të akteve të komunave dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose në faqen ueb zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Kryetarit të Komunës,*
- *Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm,*
- *Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr.133/26
Me datë:28.04.2026


Fatmir Iska
Kryesues i Kuvendit